

REPUBLICA E KOSOVES-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVA QEVERIA E KOSOVES-VLADA KOSOVA-GOVERNMENT OF KOSOVA MINISTRIA E SHENDETESISË-MINISTARSTVO ZDRAVLJA-MINISTRY OF HEALTH			
Njesia Org. Org.Jednica Org Unit	09	Nr.Prot: Broj Prot: Prot.No:	05-3970
Nr.i faqeve Br.stranica No.pages	- 21 -	Data: Datum: Date:	29/06/2023
Prishtinë / a			



## Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Shëndetësisë - Ministarstvo zdravstva - Ministry of Health

Divizioni i Prokurimit/Divizia Nabavke/Procurement Division

# KONTRATË

Numri i kontratës<sup>1</sup>: 206-23-4648-2-3-6/C296

## SHËRBIM

”Projektimi për funksionalizimin e Repartit Pediatric në Spitalin e Pergjishshëm në Mitrovicë”

Nr. i Prokurimit: 206-23-4648-2-3-6

Operatori ekonomik: **DEA GROUP SH.P.K.**

Numri Unik Identifikues: **811454636**

<sup>1</sup> Ju lutemi referojuni këtij numri të kontratës në dokumentet e faturimit dhe pagesës, procedurat dhe transaksionet që lidhen me thesarin.

# KONTRATË

Numri i kontratës<sup>2</sup>: 206-23-4648-2-3-6/C296

MINISTRIA E SHËNDETËSISË (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njërën anë; dhe

DEA GROUP SH.P.K.. PRISHTINE, KOSOVO, 811454636, (në vazhdim "Ofruesi i Shërbimeve"), në anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për shërbimet e shënuara me poshtë:

**Projektimi për funksionalizimin e Repartit Pediatrik në Spitalin e Përgjithshëm në Mitrovicë** me numër identifikues: 206-23-4648-2-3-6

## Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratës është performimi i shërbimeve në vijim nga ana e Ofruesit të Shërbimeve:

**Projektimi për funksionalizimin e Repartit Pediatrik në Spitalin e Përgjithshëm në Mitrovicë**

Nr.	Emertimi	Njësia matëse	Sasia	Çmimi për njësi Pa TVSH €	TVSH (%)	Çmimi për njësi ME TVSH €	Çmimi total me Tvsh	afati i liferimit
1	Hartimi i projektit detal për realizim për fazat: Arkitekture dhe punime ndertimore; Stabilitetin e struktureve egzistuese dhe anekset; Instalime elektrike; Instalime makinerike; Instalimet e ujit dhe kanalizimi; Mbrojtja nga zjarri; Pozicionimi i paisjeve madicionale; Inventarizimi; Specifikat dhe pershkrimi teknik; Paparamasa dhe paralogarija. Projekti kompletohet në 5 kopje fizike (liberlidhje në format A4) dhe një kopje elektronike. Në llogari merret bruto sipërfaqe e perdhese; katit dhe kulmit – brenda këtyre sipërfaqeve përfshihen dhe anekset e ashensorit dhe shkallet kundërzjarrit me nderhyrjet në parter.	M2	1567	3.15	18%	3,717 €	5,824.54 €	20 ditë

1.2 Kontrata hynë në fuqi me 30.06.2023 dhe përfundon pas 20 ditësh (pas pranimit të projektit).

1.3 Afati kohor i performancës nuk mund të jetë më shumë se 20 ditë nga data e marrjes së urdhërësës.

1.4 Vendi i kryerjes së shërbimeve do të jetë: Reparti Pediatrik në Spitalin e Përgjithshëm në Mitrovicë.

1.5 Incotermi i aplikueshëm do të jetë DDP<sup>3</sup> (Detyra e Dërguar e Paguar).

## Neni 2 Ligji i aplikueshëm

2.1 Ligji i zbatueshëm do të jetë sipas Nenit 40 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 Për çështjet që nuk mbulohen me dispozita të kontratës, zbatohen ligjet në fuqi në Kosovë. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.

<sup>2</sup> Ju lutemi referojuni këtij numri të kontratës në dokumentet e faturimit dhe pagesës, procedurat dhe transaksionet që lidhen me thesarin.

<sup>3</sup> DDP – Detyra e Dërguar e Paguar- Incoterms 2010 Oda Ekonomike Ndërkombëtare

### **Neni 3 Çmimi**

3.1 Çmimi total i kontratës do të jetë: **5,824.54 €**; [*pesë mijë e tetëqindnjëzetekatër euro e pesëdhjetekatër cent*].

3.2 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Operatorit Ekonomik sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve gjatë ekzekutimit të kontratës (në përjashtim të çmimeve të atyre artikujve që i nënshtrohen ndryshimit të çmimit sipas berzës përkatëse, nëse aplikohet).

### **Neni 4 Pagesat**

4.1 Pagesa do të bëhet në Euro.

4.2 Pagesat e detyrimeve sipas një fature të lëshuar nga Operatori Ekonomik duhet të paguhet brenda jo më shumë se 30 ditësh nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

### **Neni 5 Marrëveshjet lidhur me tatimin dhe doganën**

5.1 Operatori Ekonomik është përgjegjës për të gjitha detyrimet dhe taksat në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

5.2 Të gjitha taksat dhe detyrat e tjera doganore konsiderohen se janë të përfshira në çmimin e kontratës.

### **Neni 6 Kualiteti**

6.1 Kualiteti i shërbimeve duhet në të gjitha aspektet të plotësojë specifikimet teknike të parashtruara në Dosjen e Tenderit.

### **Neni 7 Garancioni**

7.1 Garancioni do të mbetet valid për 12 muaj, pas pranimit të shërbimeve. Operatori ekonomik para nënshkrimit të kontratës duhet të dorëzojë garancionin ekzekutimit në vlerë prej 10% të vlerës totale të kontratës për kohëzgjatjes 50 dite.

### **Neni 8 Vonesat në ekzekutim**

8.1 Nëse Operatori Ekonomik me përgjegjësinë e tij nuk arrin të realizojë ndonjë ose të gjitha shërbimet brenda limiteve kohore të specifikuar në kontratë, Autoriteti Kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së shërbimeve të pa dorëzuara deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të kontratës.

### **Neni 9 Inspektimi dhe testimi**

9.1 Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë që herë pas here të inspektojë, kontrollojë, masë dhe testojë komponentët, materialet, dhe mjeshtrinë, dhe të kontrollojë përparimin e përgatitjes, fabrikimit apo prodhimit të çfarëdo artikulli që përgatitet, fabrikohet ose prodhohet për t'u dorëzuar sipas kontratës, në mënyrë që të përcaktojë nëse komponentët, materialet dhe mjeshtrëria kanë cilësinë dhe sasinë e kërkuar.

### **Neni 10 Nën-kontraktimi**

10.1 Një nënkontratë do të jetë e vlefshme vetëm nëse është një marrëveshje me shkrim me të cilin Operatori Ekonomik i beson kryerjen e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë. Operatori Ekonomik nuk duhet të nënkontrakttojë pa autorizim paraprak me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Autoriteti Kontraktues do të njoftojë Operatorin Ekonomik për vendimin e tij brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi.

### **Neni 11 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues**

11.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Operatorit Ekonomik shtatë ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet në vijim: a) Kur operatori ekonomik nuk arrin t'i realizojë obligimet e veta sipas kontratës; b) Dështon në ekzekutimin e kontratës në afatin e caktuar; c). Refuzon urdhrat administrativ të autoritetit kontraktues; d) Ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga autoriteti kontraktues; e).

Falimenton; f). Është dënuar nga një gjykatë për një shkelje që ka të bëjë me sjellje profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res-judicata*; g) Operatori ekonomik i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e *res judicata* për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale ose ndonjë aktivitet tjetër ilegal që i dëmton interesat e përgjithshme financiare; h) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës.

#### Neni 12 Ndërprerja e Kontratës nga Operatori Ekonomik

12.1 Operatori Ekonomik, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin Kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues: a) Nuk arrin t'i paguajë Operatorin Ekonomik shumën që duhet të paguhet brenda periudhës së saktësuar me kontratë; b) vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta me kontratë; c) si rezultat i forcës madhore, Operatori Ekonomik nuk është në gjendje për të kryer një pjesë materiale të kontratës për më shumë se 180 ditë, për arsye që nuk janë specifikuar në kontratë ose që nuk i atribuohen të Operatorit Ekonomik.

#### Neni 13 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

13.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë ose vendim nga gjyqi, ose vendim arbitrimi.

13.2 Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në Gjykatën kompetente të RK në pajtim me ligjin e Kosovës.




#### Neni 14 Komunikimi

14.1 Çdo komunikim me shkrim në lidhje me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Operatorit Ekonomik duhet jap Titullin e kontratës dhe numrin e identifikimit, dhe duhet të dërgohet me postë, faks, e-mail ose me dorë, (menaxhere e kontrates nga MSh është **Znj. Tevide Konjusha**).

E hartuar në gjuhën Shqip <sup>4</sup> në tri origjinale, dy origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinal për Operatorin Ekonomik.

#### Për Autoritetin Kontraktues

#### Për Ofruesin e Shërbimeve

<b>Emri:</b>	Berat Marmullaku	<b>Emri:</b>	ARTON ZEQIR
<b>Pozita:</b>	Udhëheqës i Divizionit të Prokurimit	<b>Pozita:</b>	DREJTOR
<b>Nënshkrimi:</b>		<b>Nënshkrimi:</b>	
<b>Data:</b>	29.06.2023	<b>Data:</b>	29/06/2023
<b>Vula:</b>		<b>Vula:</b>	



<sup>4</sup> Gjuha do të jetë gjuha e përdorur nga tenderuesi në tenderin e tij.

## Aneksi 1. SPECIFIKIMET TEKNIKE TË DETYRUESHME

PROJEKTI: Funkcionalizimi i Repartit Pediatrik ne Spitalin e Pergjithshem në Mitrovicë

### ➤ GJENDJA EGZISTUESE,

Objekti si tersi arkitektonike dhe strukture ndertimore ne pergjithesi eshte e punuar mire (perveq dyshemese dhe mangesive te poshte specifikuara). Nga ajo qe eshte hasur ne terren mund te vlersohet se ne brendi te objektit ka demtime te dyshemese, posaqerisht shtresen e finalizimit egzistues me poliuretan dhe nenshtresa e estrihut - nivelizimi. Gjithashtu ne brendi ka disa mangesi qe ndikojne qe objekti te mos jete mjaftueshem i sigurte nga rrafshi i mbrojtjes nga zjarri dhe krijimi i kushteve te akomodimit adekuat, Ngrohje dhe ventilim, keto defekte egzistuese dhe mangesi mund te radhiten si me poshte. Si strukture egzistuese arkitektonike dhe funksionale, vrehen se me kohe nuk jan perfshire disa aksesore ne funksion te komoditetit, Sigurise nga zjarri dhe perpuethshmerise me standardet dhe ligjet per qasje te personave me afresi te kufizuara dhe mbrojtje nga zjarri, ventilim, ngrohje, etj. Rekomandohet qe ne vazhdim keto mangesi te plotesohen-inkorporohen ne strukturen egzistuese me konsekuenca minimale ne strukturat egzistuese, gjithashtu me konsekuenca minimale financiare. Rekomandimet per plotesimet ne vazhdim jane:

- Sanimi i dyshemese egzistuese,
  - Punimi - vendosja e nje ashensori per qasje te personave me aftesi te kufizuara dhe bartjen e pacientve,
- Vendosja e shkalleve kunder zjarrit - shkallet per evakuim,
- Ventilimi i hollit qendror permes llanternes ndriqese,
- Kopletimi i kalladtores se ngrohjes me pompa termike,
- Instalimet e nevojshme elektrike shtese dhe paisjet per fikjen e zjarrit,
- Vendosja e paisjeve medicinale
- Vendosja e inventarit te punes,



Fotografi nga gjendja egzistuese e dyshemese!

Sanimi i dyshemese eshte i domosdoshem dhe mund te realizohet sipas konceptit dhe metodologjis se propozuar ne kete raport. Plotesimet shtese (ashensori; Shkallet kunder zjarrit; ventilimet, klimatizimet; Kalldatorja, paisjet medicinale, inventari, etj - rekomandohet te realizohen pas kompletimit te dokumentacionit profesional teknik nga ekspertet e fushes ku duhet te kompletohen planimetrit detale dhe specifikat teknike me paramasen ne funksin te projektit per realizim. Ofertuesit (me vone punkryesi) - rekomandohet qe para ofertimit (ve) te ben viziten detale ne lokacionin ku kan me u zhvillue punimet dhe te ben vlersimin e kerkesave ne funksion qe kontata e realizimit te punimeve te jete sa me reale dhe pa demtime si pasoj e mungeses se parainformatave. Punkryesi (projektuesi) do te jete i obliguar qe projektin dhe dokumentacionin teknik sipas kerkesave te sipercekura duhet ta komplettoj si projekt kryesor per realizim (Sipas Ligjit te Ndertimit) ne 5 kpje identike (Liberlidhje) ne format A4.

Objekti i pediatri se femjeve eshte i vendosur ne parcelen kadastrale nr. 01870-4, zona kadastrale Mitrovicë - shiko ortofoton me poshte.



Ortofoto - lokacioni - parcella 01870-4!

➤ **SANIMI,**

**SANIMI I DYSHEMEVE EGZISTUESE,**


Sanimi i dysHEMEVE rekomandohet të realizohet në 6-të fazat si në vazhdim:

- 1.1 Preventivi dhe masat mbrojtëse të strukturave egzistuese që nuk dëmlohen (dyer; dritare; mure anësore; radiator, etj).
- 1.2 Përshkrimi dhe vlerësimi i gjendjes ekzistuese,
- 1.3 Demolimi komplet i sipërfaqeve të dysHEMEVE ekzistuese së bashku me lajsnet këndore duke I ruajtur nga demtimet instalimet e vendosura nen dysHEME,
- 1.4 Hidroizolimi horizontal i dysHemesë në përdhesë të objektit (E preferueshme),
- 1.5 Punimi i nivelizimit të ri,
- 1.6 Punimi i dysHemesë finale - Comfort Floor (ose ngjashem),
- 1.7 Punimi i lajsneve këndore, perfshi konzervimin dhe sanimin e mbeshtjelljes perimetrike.


**Përshkrimi dhe vlerësimi i gjendjes ekzistuese (dysHEMEJA),**

Reparti i Pediatriisë në Spitalin e Mitrovicës, gjendja aktuale - konstatohet:


- Sipërfaqja e dysHemesë të objektit është plasaritë dhe është shkëputë nga baza (Nivelizimi),




- Plasaritjët e nivelizimit nuk janë trajtue siç duhët ("Me çepje") para se të aplikohet dysHEMEJA finale.



- Rezistenca në tërheqje e nivelizimit është me e ulët se ajo e duhura (1,5N/mm<sup>2</sup> sipas (EN 196-1) dhe (ISO 4624), meqenëse shkeputja ka ndodhë në nivelizim.
- Cilesia e nivelizimit është jo kualitative meqenëse ka degraduar dhe është shendrruar në pluhur.



- Edhe në sipërfaqet ku në dukje të parë është mir, kanë filluar plasaritjet dhe shkeputja e dyshemesë prej bazës.



Nga sa u tha me larte, duhet qe:

- Demolimi komplet i sipërfaqëve të dyshemeve ekzistuese së bashku me lajsnet këndore,**
- Preventivi dhe masat mbrojtëse të strukturave ekzistuese që nuk demolohen (dyer; dritare; mure ansore; radiatorë, etj).
  - Të demolohen komplet të gjitha dyshemetë dhe nivelizimi deri në pllakën konstruktive. Në kuarin e ketij pozicini duhet të merrët në llogari që sistemet shperndarse të gypave nën dysheme dhe mbi pllakën rrafshuese dhe të katit të mos dëmtohen dhe të konzervohen gjatë punës,
  - Të demolohen të gjitha lajsnet këndore, Demolimi të realizohet i kontrolluar – pa dëmtime anësore të murit në suvatim dhe patinim, gjithashtu pa dëmtime të pllakave ventiluese në brendi (corridor). Nëse deri të dëmtimet vije, sanimi do jetë obligim i punëkryesit.

**Është e preferueshme të punohet hidroizolimi horizontal në perdhese (Meqenese nuk dihet me siguri si është punuar).**

Hidroizolimi të punohet me lyerje me llaç hidroizolues me 1 përbërës, për mbyllje plasaritjesh, i përforcuar me fibra dhe me bazë çimentoje të modifikuar me polimerë të posaçme rezistentë ndaj alkaleve.

Materiali për hidroizolim duhet të ketë performanc si produkt për mbrojtjen e sipërfaqës së betonit veshje për mbrojtje kundër depërtimit, kontrollë lagështie dhe rritje të rezistencës sipas EN 1504-2:2004, dhe

- Aftësia e ngushtimit të plasaritjeve 0,50 mm (Kategoria A 3, +23 °C) (EN 1062-7),
- Reagimi ndaj zjarrit Euroclass A2 (EN 13501-1),
- Depërtimi i ujit nën presion - Pa depërtim pas 72 orësh në 5.0 bar 1 (EN 12390-8),
- Depërtimi i ujit nën presion negativ - Pa depërtim pas 72 orësh në 2.5 bar (UNI 8298/8),

#### **Punimi i nivelizimit të ri,**

Furnizimi me material dhe punimi i shtresës nivelizuese me trashësi minimale 5cm dhe me keto karakteristika:

- Çimento: CEM II/42.5 R, 300 Kg/m<sup>3</sup>,
- Uje: 100 kg/m<sup>3</sup> (faktori uje/ cemento (w/c) 0.33),
- Rere lumi- aggregate: Fr:1/4 mm 1695 kg/m<sup>3</sup>,
- Shtesa - Addetive: Viscocrete 1.2 kg/m<sup>3</sup>,
- Polypropylene fiber: PPF 0.9 Kg/m<sup>3</sup>,

Dhe

- Rrezistenca në shtypje 25 N/mm<sup>2</sup> (EN 196-1),
- Rrezistenca ne Terheqje 1.5 N/mm<sup>2</sup> (EN 196-1),


#### **Punimi i dyshemesë - Shtresa finale "Comfort Floor" (ose ngjashem),**

Furnizimi me material dhe punimi i dyshemesë finale poliuretane, elastike, e përshtateshme për objekte shëndetësore - sektori medicinal - Sika Comfortfloor® PS-27 ose ngjashem),

Baza duhet të jetë e „Shëndoshë„ dhe me rezistencë të mjaftueshme në shtypje (minimum 25N/mm<sup>2</sup>) dhe në tërheqje 1,5N/mm<sup>2</sup>. Lagështia e nënshtresës duhet të jetë më e vogël se 4%.

Nënshtresa duhet të jetë e pastërt, e thatë dhe pa materiale kontaminuese, si p.sh. papastërti, vaj, yndyrë, lyerje dhe përpunime të ndryshme të sipërfaqës së nënshtresës.





Layer	Product
1. Primer	Sikafloor®-150/-151
2. Base coat	Sikafloor®-327
3. Top coat	Sikafloor®-305 W (min. 2 layers)

Për punimin e dyshemesë epokside të tipit Sika Comfortfloor® PS-27 (ose ngjashem) duhet të plotësohen këto kushte:

#### Struktura e Sistemit:

Para se të fillohet me aplikimin e Sistemit të dyshemesë "Sika Comfortfloor® PS-27" (ose ngjashem), duhet të pergaditet nënshtresa. Nënshtresa pergaditet me grryerje me makinë e deri në hapje të strukturës së sipërfaqes. Pergaditja bëhet me qëllim të largimit të pjesëve të lidhura dobët dhe jo stabile dhe hapje të strukturës së nënshtresës. Pluhuri i grryer thithet me thithëse industriale.

Dyshemeja elastike poliuretane "Sika Comfortfloor® PS-27" (ose ngjashem), i plotëson këto karakteristika teknike:


- Rrezistenca në abrasion < 3000 mg sipas normës (EN ISO 5470-1),
- Resistenca në goditje, Klasa- I', sipas (ISO 6272),
- Rezistenca në tërheqje > 2.0 N/mm<sup>2</sup> si, pas (EN 13892-8),

Dhe këto standarde:

- Klasifikimi i zjarrit sipas EN 13501-1, raport CR-13-167/1 Universiteti i Gentit,
- Material rrëshirë sintetike sipas EN 13813:2002, Deklarata e Performancës dhe pajisur me markën CE,
- Mbrojte sipërfaqësore për beton sipas EN 1504-2:2004,
- Mbrojtje të mjedisit – AgBB - Skemat dhe udhëzimet franceze të etiketimit të testuara sipas ISO-16000, Report No 392-2013-00094801\_02,

#### Punimi i lajsneve këndore,

Furnizimi me material dhe punimi i lajsneve këndore nga llaçi epoksid sipas detajit të meposhtëm. Në kuadrin e këtij pozicioni përfshihen edhe: Preventivi i perimetrit të dyshemesë në mure, në lartësi deri në 100cm duhet konzervuar dhe sanuar në tërësi dëmtimet e munshme nga punimet sanuese.



Planimetritë egzistuese të objektit:





Tabela teknike - karakteristikat Teknike të Objektivit

Nr.	Hapsira	Krevate	S (m2)	P (m)	H (m)	DysHEMEJA egzis.	Shenim
<b>PERDHESA</b>							
1	Holli/Korridor		150	69	3.5	Poliuret	DysHEMEJA e demtuar
2	Dh. Per lojrat e femijve		32.3	24.3	3.5	Poliuret	DysHEMEJA, jo stabile
3	Garderoba		7.6	12.5	3.5	Poliuret	
4	Material Shpenzues		7.6	12.5	3.5	Poliuret	
5	WC - Personeli		7.7	12.5	3.5	Poliuret	
5/a	WC - Personeli - F		3.8	7.8	3.5	Pll. Graniti art.	
5/b	WC - Personeli - M		3.8	7.8	3.5	Pll. Graniti art.	
6	WC - Pacient		7.7	12.5	3.5	Poliuret	
6/a	WC - Pacient - F		3.8	7.8	3.5	Pll. Graniti art.	
6/b	WC - Pacient - M		3.8	7.8	3.5	Pll. Graniti art.	
7	Dh. E pushimit te mjekve		16	16.1	3.5	Poliuret	DysHEMEJA, jo stabile
8	Dh. Per trajtim ditor - 1	3	24.3	21	3.5	Poliuret	DysHEMEJA, jo stabile
9	Dh. Per trajtim ditor - 2	3	27.7	22	3.5	Poliuret	DysHEMEJA e demtuar
10	Laboratori		18.7	17.8	3.5	Poliuret	
11	Dh. e Drejtorit te Pediatrise		18.8	17.8	3.5	Poliuret	DysHEMEJA, jo stabile
12	Kontrolli I pacientve - 4		18.8	17.8	3.5	Poliuret	DysHEMEJA e demtuar
13	Kontrolli I pacientve - 3		18.8	17.8	3.5	Poliuret	
14	Kontrolli I pacientve - 2		18.8	17.8	3.5	Poliuret	DysHEMEJA, jo stabile
15	Kontrolli I pacientve - 1		21.4	18.8	3.5	Poliuret	DysHEMEJA e demtuar
16	Shkallet		22	21	3.5	Poliuret	DysHEMEJA, jo stabile
		<b>6</b>	<b>433.4</b>	<b>362</b>			

Sip. BRUTO: 483

Nr.	Hapsira		S (m2)	P (m)	H (m)	DysHEMEJA egzis.	Shenim
<b>KATI</b>							
17	Holli/Korridor (pa galeri)		120	88	3.5	Poliuret	DysHEMEJA e demtuar
18	Informieret		32.3	24.3	3.5	Poliuret	DysHEMEJA, jo stabile
19	Mjeku		15.8	16	3.5	Poliuret	DysHEMEJA e demtuar
20	WC per pacient		7.7	12.5	3.5	Poliuret	
20/a	WC - Pacient - F		3.8	7.8	3.5	Pll. Graniti art.	
20/b	WC - Pacient - M		3.8	7.8	3.5	Pll. Graniti art.	
21	Kuzhina e nenave		7.7	12.5	3.5	Poliuret	
22	Kontrolli I pacientve	1	19.3	20	3.5	Poliuret	DysHEMEJA, jo stabile
22/a	Banjo		4.6	8.8	3.5	Pll. Graniti art.	
23	Material shpenzues		8.4	13.5	3.5	Poliuret	
24	Kontrolli I pacientve	3	28.5	27	3.5	Poliuret	DysHEMEJA, jo stabile
24/a	Banjo		3.5	7.7	3.5	Pll. Graniti art.	
25	Kontrolli I pacientve	3	31.5	27.5	3.5	Poliuret	
25/a	Banjo		3.5	7.7	3.5	Pll. Graniti art.	
26	Kontrolli I pacientve	2	21.2	22.5	3.5	Poliuret	
26/a	Banjo		4	8.3	3.5	Pll. Graniti art.	
27	Kontrolli I pacientve	2	21	22.5	3.5	Poliuret	DysHEMEJA, jo stabile
27/a	Banjo		4	8.3	3.5	Pll. Graniti art.	
28	Kontrolli I pacientve	2	21	22.5	3.5	Poliuret	DysHEMEJA, jo stabile
28/a	Banjo		4	8.3	3.5	Pll. Graniti art.	
29	Kontrolli I pacientve	2	21	22.5	3.5	Poliuret	
29/a	Banjo		4	8.3	3.5	Pll. Graniti art.	
30	Kontrolli I pacientve	2	21	22.5	3.5	Poliuret	
30/a	Banjo		4	8.3	3.5	Pll. Graniti art.	
31	Kontrolli I pacientve	2	22.9	23.5	3.5	Poliuret	
31/a	Banjo		4	8.3	3.5	Pll. Graniti art.	
32	Hapsira e shkalleve		22	21	3.5	Poliuret	
		<b>19</b>	<b>464.5</b>	<b>488</b>			

Sip. BRUTO: 542

Gjithsejtë (Perdhese+Kati):	25	897.9	850
Sip. BRUTO:		1025	

**Vërejtje :**

- Të gjitha punimet e pershkuara më lartë ne këtë Pershkrim Teknik duhen të ekzekutohen nga Kompania e specializuar dhe e certifikuar për këtë llojë punimesh.
- Mbikëqyrja profesionale duhet të bëhet nga personat e kualifikuar dhe me pervoje ne këto llemi të ndërtimtarisë.
- Kontraktori para fillimit të punimeve, duhet qe të sjelle mostrat e materialeve me dokumentacion teknik per aprovim per pozicionet e:
  - 1.Certifikata nga prodhuesi i materialeve, që dëshmojnë se kompania ndërtimore është e autorizuar nga prodhuesi për punët specifike.
  - 2.Certifikatat e cilësesë se produkteve dhe materialeve,
  - 3.Atestet e materialeve nga punishtja,
  - 4.Diplome ose certifikate që stafi profesional është i trajnuar për punime specifike, Mostrat dhe dokumentacioni teknik përcjellës duhet qe të dëshmojnë plotësimin e kërkesave teknike sipas Pershkrimit Teknik.

**➤ PUNIMI - VENDOSJA E NJË ASHENSORI PËR QASJE TË PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUARA DHE BARTJA E PACIENTVE NGA PERDHESA NE ETAZHIN 1,**

Në objektin e pediatriisë të fëmijëve, kerkohet qe të vendoset - inkorporohet një ashensorë per bartjen e personave me aftesi te kufizuara dhe bartje te pacientve nga perdhesa ne etazhin 1. Ashensori vendosët në afersi të shkallëve kryesore, me qasje direkte nga hollet qendrore. Dimensionet e brenshme të kabinës nuk munden me qenë me të vogla se 2.2mx1.2m. Ashensori te jete panoramik ne drejtim te hyrjes.

Aktivitetet e parashikuara per vendosje te ashensorit:

- Demolimi dhe largimi i strukturave egzistuese për vendosjen e ashensorit (Preventivi dhe konzervimet; hapja e pllakave; dritare; radiatorë me instalime; etj.).
- Gërmimi dhe largimi i materialit të gërmuar për bazamentin e ashensorit,
- Mbushjet dhe shtresat bazike dhe rrethore të bazamentit të ashensorit, mbushjet me zhavorr fr-0.63mm dhe 0.32mm,
- Shtresa rrafshuese e bazamentit të ashensorit, perfshi muret suportuese anësore, relizohet me struktura betoni të armur me „Q 211“, dhe Betoni C-27/30,
- Hidroizolimi dhe drenazhimi i bazamentit të ashensorit,
- Sanimet dhe modifikimet e strukturave egzistuese solide të objektit egzistues, sanimi bëhet me beton të armuar C-27/30, me armim 75Kg/m<sup>3</sup> beton.
- Betonimi i struktures së kafazit të ashensorit nga bazamenti deri të kulmi, kafazi të jetë me nivelin e poshtëm jo më pakë se 1.4m (nën nivelin e dyshemesë të përdhesës) dhe pllaka e kulmit të kafazit të jetë jo më pakë se 1.2m me lartë se pllaka e mbi etazhit 1.
- Sanimi dhe adaptimi i kulmit në objekt, ashensor dhe rreth ashensorit – sipas materializimit në objektin bazik. Materializimi përfshin sanimin e shtresave egzistuese ne objekt, adaptimet sipas nderhurjes së ashensorit me objektin bazik dhe mbulimi i kafazit të ashensorit. Shtresat pershin termoizilimet, shtresat suportuese strukturale

solide, shtresa hidroizoluese dhe mbulesa, perfshi sistemin për largim të ujrave - komplet në harmoni me shtrukturat egzistuese të mbulesës egzistuese.

- Fabrikimi dhe montimi i zdrugtharisë ndërtimeore për objektin bazik dhe kafazin e ashensorit - në sistemin e fasadës gjysëm strukturale, përfshi dhe derën hyrëse në objekt (përdhese) dhe dritarës për ventimim. Struktura të jetë me koeficient të depertueshmerisë termike jo më pake të volitshem se 1.1 W/m<sup>2</sup>K.
- Sanimet perimetrike të mureve dhe plafoneve në funksion të finalizimit të ashensorit, këtu përfshihen adamantimet me beton, beton të armuar, mbeshtjellje me struktura metalike, termoizoluese, hidroizoluese, etj.
- Suvatimi dhe patenimi me ngjyrosje të mureve të brenshme të kafazit, suvatimi behet me llaq të parafabrikuar NP-75, Patenim me llaq gipsi t=2mm, lysterjet me fluidet për ngjitje dhe lidhje, Ngjyrën finale plastike dhe aksesorët percjellës.
- Punimi i fasadës mbështjellëse të ashensorit me pllaka ventiluese nga porcelani, t=6mm „Kale-sinteflex“ (ose ngjashëm), përfshi sistemin mbajtës adekuat, shtresën termolizoluese nga leshi i gurit me trashësi 10cm (75Kg/m<sup>2</sup>), përfshi adaptimet rrethanore në funksion të inkorporimit me objektin egzistues,
- Fabrikimi dhe montimi i dymve rreshçitese hyrëse në ashensor (2 copë), me gjerësi 110cm, punohen nga INOX, përfshi kuadrin automatik operativ. Në llogari përfshihet dera rreshçitëse me palim nga 3 panelle dhe korniza me sistemin mbështesës fiks, përfshi aksesorët percjelles.
- Fabrikimi dhe montimi i ashënsorit hidraolik me specifikat bazike: Dimensioi i brenshëm i kabines (e shfrytezuar) te jetë 120x220cm; kabina e kafazit e kompletuar nga inox dhe qelqi; me ventilim të kabinës, me ndriqim dhe zërim të kabinës; shpejtesia maksimale e levizjës max. 1.5m/sec. Kabina të ketë dritare ndriquese nga ana e hapjes së kafazit; 2 ndalesa për hyrje-dalje; Kafazi të jetë i paisur me doreza mbajtëse; të ketë sistemin operativ të kompletimit për urdhësesës e fundit në rastet kur ka ndërprerje të furnizimit me energji elektrike; kabina të jetë e paisur me nje bocë manuale për fikjen e zjarrit; Kabina të jetë ne brendi me paqyrë ne të dy drejtimet pa hapje; Hyrjet në ashensorë të mbulohe me pllaka nga graniti natyrel t=20mm - antarcid.
- Sistemi i furnizimit dhe operativ elektrik të rrymave të forta dhe rrymave të dobëta - standarde sipas sitemit të fabrikuar të ashensorit dhe aksesorëve të sigurisë, përfshi tokëzimin dhe rrufembrojtësin standard. Sistemi i furnizimit të jetë nga kutija shpërndarëse përmes kanaleve fleksibile, përfshi sistemin e veqantë të siguresave.

#### ➤ **VENDOSJA E SHKALLËVE KUNDER ZJARRIT - SHKALLËT PER EVAKUIM DHE MBROJTJA NGA ZJARRI,**

Në objektin egzistues të pediatriisë në Spitalin e Përgjithshëm në Mitrovicë, referuar gjendjës egzistuese të strukturës së objektit dhe ligjeve (Ligji nr. 04 L/012) në fuqi që determinojnë mbrojtjen nga zjarri dhe largimin emergjent nga objekti, kerkohet që objektit ti vendosen shkallët për evakuim emergjent (evakuimi nga kati 1). Mbrojtja nga zjarri përfshinë vendosjen e aparateve manuale standrde për fikjen e zjarrit dhe vendosjen e sinjalistikës orientuese dhe për largim emergjent. Aktivitetet dhe punimet që nevoiten në situaten konkrete janë:

- Demolimi i strukturave egzistuese në parter (Kubza betoni, nënshtresa, etj - organike dhe jo organike) për vendosjen e shkallëve emergjente.

- Gërmimi i bazamentit të pllakës rrafshuese mbi të cilën vendosen shkallët kunder zjarrit, thellësija e gërmimit të jetë 80cm nga niveli i pllakës rrafshuese të dyshemesë së Përdhësës,
- Nënshtrësat dhe brendambushja me mbushje zhavorrike (0.62mm dhe 0.31mm), përfshi planifikimin edhe kompaktësimin.
- Preventivi dhe konzervimi i strukturave egzistuese për mbrojtje nga dëmtimet e pjesve dhe strukturave që ngelën në funksion,
- Demolimi dhe largimi i zdrugtharisë egzistuese në katë, për adaptim me shkallët për evakuim,
- Fabrikimi dhe vendosja në vend e zdrugtharisë ndërtimore të re (në katë), përfshi dhe derën qasëse në shkallët emergjente më gjerësi të krahut min.100cm, dhe dritarës për ventimim. Struktura të jetë më koeficientë të depertueshmerisë termike jo më pakë të volitshem se 1.1 W/m<sup>2</sup>K.
- Punimet sanuese perimetrike pas ankorimit dhe vendosjës së zdrugtharisë ndërtimore në katë, në kuadrin e këtyre punimeve hyjnë: sanimi i suvatimit egzistues; sanimi i plafonit; sanimet në mure; suvatim me patinim, ngjyrosje dhe aksesoret tjere për funksionalizim.
- Sjellja e materialit dhe betonimi i pllakës rrafshuese t=30cm dhe sokllës mbi të cilën vendosen pllakat ankoruese metalike për shtyllat e sistemit metalik, mbi të cilën vendosën shkallët për evakuim, përfshi armimin 75Kg Armim/m<sup>3</sup> të betonit, përfshi gjithashtu ankerët për pllakat e çelikut mbi të cilet vendosen shtyllat e çelikut të konstruksionit të shkallëve per evakuim.
- Sjellja e materialit dhe punimi i shtrojës së parterit nën shkallë me kubza betoni të reja dhe anësore betoni, përfshi nënshtrësen me rërë (t=10cm).
- Adaptimi dhe sanimet e fasadës egzistuese pas montimit dhe fiksimit të shkallëve për largim emergjent, ketu hyjnë adaptimi dhe sanimet në fasaden egzistuese „Demit“ t=100mm, përfshi ngjyrosjen e fasadës.
- Fabrikimi, sjellja dhe montimi i strukturës metalike komplete të shkallëve për largim emergjent,
- Pastrimi dhe sanimet periferike pas funksionalizimit të shkallëve për largim emergjent,
- Aparate manuale për fikjen e zjarrit me pluhur - P9, vendosën sipas projekt-konceptit, ne lartësi sipas sntandardeve,
- Aparate manuale për fikje të zjarrit me gaz - 5L, vendosën sipas projekt-konceptit, ne lartësi sipas sntandardeve,
- Aparate manuale për fikje të zjarrit me gaz - 10L, vendosën sipas projekt-konceptit, ne lartësi sipas sntandardeve,
- Sinjalistika standarde për Dalje; Largim emergjent; evakuim; etj, vendosen sipas projekt-konceptit, ne pozicionet sipas sntandardeve,
- Metodologjia e realizimit dhe e materializimit te shkallve per evakuim mund te kete analogji sipas projektuesit por ne parim ruhet koncepti i sipercekur i specifikimit dhe pershkrimnit teknik,

#### ➤ VENTILIMI I HOLLIT QENDROR PËRMES LLANTERNËS NDRIQUESE DHE KLIMATIZIMI,

Objekti egzistues i spitalit pediatrik në Mitrovicë, nga ndërtimet baze nuk ishte trajtuar mjaftueshëm për ventilim dhe klimatizim. Holli qendror është i mbuluar me një llanternë

ndriqese, me dy sisteme hidraoliko-elektrike për hapje-mbyllje, të cilat fatkeqesishtë nuk funksiononin me rastin e vizites në terren. Nen-llanternat në nivelin e etazhit 1, është e rrethuar me mure nga PVC dhe Xhamai, hapësirë kjo që përmes galerisë lidhet direkt me hollin qendror në përdheshë. Nga aspekti temik, nën-llanternat dhe njëkohsishtë edhe hollin qendror në përdheshë mbingroheshin në sezonin e verës dhe humbenin ngrohen në sezonët e dimrit. Problemi i veçantë është paraqitur mbingrohja. Për të zvogluar efektin e mbingrohjes dhe humbjet në energji, kerkohet që në zonën e llanternës ndriqese të ndërhyhet me aktivitetet si:

- Demolimi i tri fushave të dëmtuara të qelqit egzistues. Në llogari të merret vendosja e skeleve për qasje në vendin e punimeve dhe masat tjera preventive,
- Sanimi i tri fushave nga qelqi termopan – duke i sjellë panellet e reja - xhami i kalitur (Xham: 6mm + PVC folje + Xham 6mm), përfshi kornizen perimetike mbajtëse të panellëve sipas dimensioneve specifike në vend. Kjo projektohet sipas gjendjes periferike.
- Sjallja e materialit dhe vendosja e dy centrifugave për sjellje dhe largim të ajrit. Centrifugat të jenë elektrike me diametër  $d=40\text{cm}$  - si centrifuga qendrore (750 rrotullime në minute), njëra centrifugë sjellë ajrin e pastër nga mbikulmi dhe centrifuga e dytë largon ajrin e mbingrohur nga brenda jashtë. Centrifugat të jenë të sistemuara në korniza PVC ose nga Alumini, kur aktivizohen me qark elektrik, shpatëzat mbuluese hapën si rezultat i cirkulimit të ajrit me presion tërheqës (si masë sigurie për mosfutjen e shpezve dhe insekteve nga jashtë brenda), kur centrifugat nuk funksionojnë – shpatëzat mbuluese rrinë të mbyllura. Centrifugat vendosen nga të dyja anët e kallkaneve egzistuese të kulmit ndriqes të llanternës. Centrifugat aktivizohen me qarqe adekuate elektrike përmes kabllave furnizuese në kanalet fleksibile PVC. Në llogari të përfshihen kabllot furnizuese, hapje/mbylljet vrimave për vendosjen e centrifugave në mure, adaptimet e vend-vendosjeve të centrifugave dhe të gjithë aksesoret me punimet adekuate për fiksimit dhe funksionalizimin të centrifugave dhe procesit të sjelljes me largim ajri.
- Sjellja e materialit dhe punimi i plafonit nga konstruksioni i alominit me mbajtëse çeliku, me fusha ndriqese në hapjet  $60\times 60\text{cm}$ , ndriqimi bëhet përmes paneleve nga Xhami i kalitur si panele termopan  $60\times 60\text{cm}$ , mbi profilet fikse nga alumini në sistemin  $60\times 60\text{cm}$ . Koeficienti i depertueshmërisë termike të plafonit ndriqes të lëshuar të jetë jo më pakë se  $0.9\text{ W/m}^2\text{K}$ . Plafoni i lëshuar ndriqes, me panele termopan qelqi vendoset në nivelin e plafonit të etazhes 1. Panelet e qelqit janë të zalluara (jo transparente) në dy shtesa xhami dhe në mesë me shtresë termike nga argoni (rreth, 20mm). Plafoni i lëshuar mbahet nga profilet e ankoruara të çelikut me dimensione në prerje terthore  $20\times 10/6\text{mm}$ , të vendosura në distanca jo më të mëdha se 1.2m. në kuadrin e punimeve parashifen vendosja e skeleve, punimet e demolim-sanimeve për fiksimin e profileve mbajtëse nga çeliku dhe Alumini dhe aksesoret mbajtës në varje. Funkcioni i plafonit të varun është që të krijohet një zonë tamponi e ajrit në mes të ambienteve të brendshme dhe mbuleses së kulmit nga qelqi (mbulesa). Kur ajri në tamponin e mbiambienteve ngrohet, ndërrimi dhe ventilimi për freskim bëhet përmes dy centrifugave dhe si rezultat do kemi largimin e mbingrohjes dhe ruajtjen e temperaturave në sezonin e dimrit. Në kuadrin e punimeve hyjnë edhe ngjyrosja e mureve pas sanimeve adekuate dhe punimeve ndërtimore.
- Sjellja e pajisjeve, montimi dhe funksionalizimi i njesive për klimatizim – njësi (18-teshe) për kthinat (2; 7; 10; 11; 12; 13; 14; 15; 17 (dy copa (P+K) me kondenzim në tualete); 18 dhe 19). Klimat njësi vendosen nga dy elemente muri (i brendshëm dhe i jashtëm), përfshi ankorimin në mure dhe sistemin ndërlidhes dhe largues të ujit të kondenzuar. Vendosën në muret e jashtme në lartësi adekuate dhe me sistem adekuat furnizimi dhe

kontrolle elektrike dhe distanc-dirigjuese. Në kuadrin e punimeve llogariten të gjitha punimet ndërtimore/demoluese/adaptuese dhe sanuese ndërtimore për fiksimit dhe funksionalizim.

- Metodologjia e realizimit dhe e materializimit të ventilimit mund të ketë analogji sipas projektuesit por në parim ruhet koncepti i sipërcekur i specifikimit dhe përshkrimit teknik,

#### ➤ **KOMPLETIMI I KALLDATORËS SË NGROHJES ME POMPA TERMIKE**

Objekti egzistues i spitalit pediatrik në Mitrovicë, nga ndërtimet baze nuk ishte trajtuar mjaftueshëm për:

- Fabrikimi, sjellja dhe montimi i komplet sistemit të kalldasë - ngrohjes me pompa termike adekuate për volumin hapsinor të strukturat funksionale egzistuese në objekt. Sistemi ngrohës parashifet të vendoset nën shkallët kryesore ku duhen të vendosen të gjithë aksesoret adekuatë për ngrohje me pompa termike, përfshi të gjitha paisjet dhe aksesoret përcjellës për funksionalizim të ngrohjes me pompa adekuate termike dhe pajisje dhe rrjetet përcjellëse brenda sistemit të kalldasë me pompa termike. Në kuadrin e punimeve (ofertesit, dhe me vone për realizim) përfshihen:
  - Incizimi detal i hapësirës së nënshkallëve, përfshi instalimet egzistuese,
  - Planifikimi dhe vizatimi i detaleve për realizim, përfshi llogaritë e nevojshme termike dhe funksionale,
  - Furnizimi me njetësi duhet të jetë standard 22/26 °C, përfshi dhe furnizimin pa ngrohje të sistemit për freskim në ambiente të brendshme në muajt e verës.
  - Sjellja dhe vendosja e rezervuarëve dhe citernave të ujit,
  - Vendosja e pompave termike dhe aksesoreve adekuat përcjellës, si njësi të brendshme dhe të jashtme të kompletuara për funksionalizim,
  - Të gjitha punimet ndërtimore/sanuese të vendosjes së sistemit të pompave termike dhe aksesoreve përcjellës.
  - Kapaciteti volumor i objektit të merret nga tabela teknike në raport - sipërfaqe neto dhe volum neto,
  - Vendosja e rrjeteve ndërlidhëse të lagura (Hidroinstalime) dhe të thata (rryma, etj),
  - Fillimi i realizimit bëhet pas projektimit detal për realizim të ngrohjes dhe aprovimit nga autoriteti kontraktues.
  - Rrjeti i furnizimit të radiatorëve dhe radiatorët janë të realizuara nga punimet e mëhershme, nëse gjatë punimeve të dyshemesë vjenë deri të dëmtimet e pa sanueshme të gypave furnizues dhe marrës (egzistues) - në këto raste mund të parashikohen punime shtesë për kompenzim.

#### ➤ **INSTALIMET E NEVOJSHME ELEKTRIKE SHITESË DHE PAISJET PËR FIKSIMIN E ZJARRIT**

Nga vizita e bërë në objektin e ri të Pediatrikës në Mitrovicë, shihet se objekti është i kyqur në TS-in 10(20)/0.4kV, i cili TS është në kuadër të spitalit. Gjithashtu është realizuar edhe furnizimi alternativ i objektit nga Gjeneratori Qendror spitalor. Nga ajo që është vërejtur, shihet se objekti ka furnizim me energji elektrike. Në përgjithësi, është e nevojshme një fiksimit i pjesshëm i pajisjeve, psh. Prizat, detektorë,...

Në hyrje të objektit shihet se janë hequr dy shtylla të ndriçimit të jashtëm, të cilat duhet të zëvendësohen me të reja. Në objekt mungon ndriçimi emergjent, i cili duhet të vendoset.



Projektuesi është i obliguar që aksesoret egzistues elektrik në objekt të verifikoj dhe të shtoj ato të domosdoshme si pasojë e mungesave në fazën e parë të punimeve dhe plotësimet teknologjike dhe funksionale për sanim dhe funksionalizim.

#### ➤ **PROJEKTI DETAL I PAISJEVE MEDICIONALE - VENDOSJA DHE FUNKSIONALIZIMI**

Projektuesi është i obliguar që në objekt (projekt) të parashihet të gjitha paisjet medicinale adekuate për funksionalizim të Klinikës së pediatrie, paisjet parashikohen dhe projektohen si të pozicionuara sipas rekomandimeve nga stafi (grupi) monitorues – stafi medical nga SR Mitrovicë. Kërkohej listë e veqantë për blerje, furnizim dhe montim me procedurë sipas LPP të veqantë – vendosen në fazën adekuate të kompletimit të punimeve ndërtimore.

#### ➤ **PROJEKTI DETAL I INVENTARIT - VENDOSJA DHE FUNKSIONALIZIMI**

Projektuesi është i obliguar që në objekt (projekt) të parashihet të gjithë inventarizimin e punës (mobilerinë) adekuate për funksionalizim të Klinikës së pediatrie, mobileria parashikohet dhe projektohen si të pozicionuara sipas rekomandimeve nga stafi (grupi) monitorues – stafi medical nga SR Mitrovicë. Kërkohej listë e veqantë për blerje, furnizim dhe montim me procedurë sipas LPP të veqantë – vendosen në fazën adekuate të kompletimit të punimeve ndërtimore.

Në fazën e projektimit, projektuesi është i obliguar që në harmoni me rekomandimet dhe kërkesat e stafit nga SR Mitrovicë, në dokumentacion teknik të përfshin mobilerinë eventuale e cila si pasojë e fazës së parë të punimeve ka ngelur jashtë sistemit.

#### ➤ **Kërkesat e Projektit**

Duke u bazuar në gjendjen ekzistuese të përshkruar me sipër, hartuesi i projektit është i obliguar që duke ju referuar detyrës projektuese të bëjë analizat e gjendjes ekzistuese të objektit, konform analizës paraprake, verifikimit të gjendjes dhe kërkesës për plotësim nga Investitori të hartoj projektin detaj për ekzekutim.

Projektuesi gjatë hartimit të projektit kryesor duhet të përdorë dhe të rishikojë të gjithë informacionin ekzistues për gjendjen e objektit.

Projektuesi duhet që në kuadrin e hartimit të projektit të trajtoj të gjitha hapësirat e objektit dhe nëse ka nevojë për ndryshime eventuale të paraqes ato për miratim para investitorit.

Projektin duhet të hartohet në bashkëpunim të plotë me autoritetin kontraktues dhe SR Mitrovicë.

Projektuesi duhet të hartoj dhe të paraqesë paraprakisht analizën së bashku me skemat grafike të zgjidhjeve të bera tek investitori për miratim.

Projektuesi duhet që të bëjë analizën e strukturës ekzistuese të objektit dhe të jep rekomandimet përkatëse dhe vlerësimin për gjendjen e strukturës së objektit të cilat duhet të jenë pjesë e projektit të strukturës.

Të gjitha elementet në pikat e mësipërme të paraqitura në gjendjen ekzistuese të projektohen duke siguruar një zgjidhje të përshtatshme për funksionin e objektit.

Projektin do të hartohet në përputhje me të gjitha normat dhe standardet për projektim, që parashikon legjislacioni në fuqi. Projektimi duhet të sigurojë respektimin e standardeve, madje edhe atyre gjatë zbatimit. Është përgjegjësi e projektuesit saktësia dhe respektimi i të gjitha standardeve dhe normave përkatëse.

Projektuesi mund te propozoje edhe zgjidhje innovative duke respektuar normat dhe praktika me te mira ne projektim dhe zbatim te projekteve, ne rastet kur paraqiten keto rekomandime duhet qe te permbajne elemente te fizibilitetit dhe kostot financiare.

Projektuesi gjate hartimit te projektit duhet qe te paraqese para investiorit per miratim materialet e perdorura ne projektim te cilat duhet ti permbushin kriteret e cilesise dhe konformitetit per te gjitha elementet e projektit.

Projekti duhet te permbaje procesin detal te punes por nuk kofizohet ne: metodologjiine e punes, cilesine e kerkuar, format e miratuara ngjyrat e rekomanduara, skicat grafike etj.

Ne hartimin e projektit duhet te parashikohet infrastruktura e nevojshme per kategori te personave me aftesi ndryshe.

Ne hartimin e projektit, projektuesi duhet te perdore programet kompjuterike per projektim dhe dorezimi i projektit te behet edhe ne programin projektues.

Projekti duhet te permbaje deklaratat e pergjegjesise profesionale te firmes projektuese dhe stafit te saj pjesmarres ne hartimin e projektit.

Dorezimi final i projektit do te konsiderohet ateher kur projekti ka perfunduar ne te gjitha fazat e projektit (te pershkuara ne oferten financiare), i ploteson normat e projektimit, eshte i gatshem per zbatim dhe eshte miratuar nga investitori.

Projekti kryesor per zbatim duhet te permbaje pjesen tekstuale dhe pjesen grafike

Pjesa tekstuale:

Analiza e gjendjes ekzistuese

Pershkrimi teknik i detajuar i puneve dhe procesit te punes,

Specifikimi teknik i detajuar per materialet e perdorura,

Paramasa dhe parallogaria se bashku me vleren financiare, per punet ndertimore

Paramasa dhe parallogaria se bashku me oferten financiare per inventar dhe paisje medicinale

Analiza dhe punimi i elaboratit per mbrojtje nga zjarri.

Pjesa grafike:

Faza e arkitektures

Bazat e objektit ekzistuese me anekse (plotesime) - planimetria ne perpjese  $P=1/50$

Bazat e objektit me organizim sipas pershkrimit ne gjendjen ekzistuese  $P=1/50$

Prerjet terthore dhe gjatesore te objektit ne perpjese  $P=1/50$

Detalet e sanimeve te paraqitura ne perpjese  $P=1/25$

Planet detale per ndryshimet ne strukturen e objektit ne perpjese  $P=1/25$

Instalimet elektrike

Planet detale te instalimeve elektrike ne perpjese  $P=1/100$

Planet e propozuara per ndryshime te instalimeve elektrike  $P=1/100$

Detalet e sanimeve per instalimet elektrike perpjese  $P=1/25$

Instalimet makinerike

Skemat grafike te instalimeve makinerike perpjese  $P=1/100$

Detalet e propozuara per plotesime, ndryshime te instalimeve makinerike dhe detalet e sanimeve P=1/25 dhe P=1/50

Instalimet e ujesjellesit dhe kanalizimit

Planimetria e sistemit te hirdosanitarise dhe kanalizimit P=1/100

Detalet e propozuara per plotesim, ndryshime ne sistemin e ujit dhe kanalizimit dhe sanimet, perpjese P=1/25 (1/50)

Projekti dorezohet ne 5 kopje fizike ( liberlidhje ne format A4) dhe nje kopje elektronike CD (ne programin e projektuar, format pdf, word , excel).



## SIGURIMI I EKZEKUTIMIT TË TENDERIT

Për: **Ministria e Shëndetësisë**  
(në vazhdim "Autoriteti Kontraktues").

Në emër të: **DEA GROUP SH.P.K. , Rr. Prekazi 36 Prishtine**  
(në vazhdim "operatori ekonomik").

Titulli i aktivitetit të prokurimit dhe Numri i prokurimit: Projektimi për funksionalizimin e Repartit Pediatrik në Spitalin e Përgjishshëm në Mitrovicë  
206-23-4648-2-3-6

### Garancion me kërkesë të parë

DERISA operatori ekonomik i lartcekur, ka ndërmarrë veprimet për të dorëzuar një siguri të ekzekutimit duke iu referuar Dosjes së Tenderit, me numër të prokurimit të lartcekur të dërguar nga Autoriteti Kontraktues;

DHE NGASE operatori ekonomik dëshiron të depozitojë sigurinë në shumën e saktësuar në Dosjen e tenderit;

DHE NGASE ne jemi pajtuar t'i japim operatorit ekonomik këtë siguri;

ANDAJ NE të poshtë nënshkruarit, me këtë konfirmojmë se jemi garantues dhe përgjegjës para jush, në emër të operatorit ekonomik, deri në një total prej: **Pes qinde e Tetedhjetë e Dy e Katerdhjetë e Pes 582.45 €** zotohemi të ju paguajmë, që me kërkesën tuaj të parë me shkrim në të cilën deklarohet mos përmbushja e njërit nga kushtet në vijim:

a) Autoriteti kontraktues ka konstatuar në bazë të dëshmive të vërtetueshme objektivisht se operatori ekonomik ka dështuar që të ekzekutojë kontratën e nënshkruar dhe kjo i ka shkaktuar autoritetit kontraktues dëme substanciale dhe/ose shpenzime të mëdha për mbylljen e kontratës në fjalë, dhe

b) Operatori ekonomik ka dështuar që të ekzekutojë kontratën e nënshkruar dhe si rezultat i saj kanë mbetë pa u paguar shumë punëtorë, nënkontraktorë dhe/ose furnizues të materialeve.

Pagesa në shumën e limituar prej: **582.45 €** siç është lartcekur, do të bëhet pa asnjë kundërshtim as ankesë, sa më shpejt që është e mundur pas regjistrimit të kërkesës suaj me konfirmimin 'e pranimit'.

Kjo siguri është e vlefshme **50 ditë prej 29.06.2023** deri më **18.08.2023**

Garancioni në fjalë skadon tërësisht dhe në menyrë automatike nëse kërkesa e juaj nuk ka arritur në K.S "SIGKOS" sh.a më së voni deri në datën e shënuar më lartë.

Nënshkrimi dhe yula e Garantuesve

Emri i bankës ose i institucionit financiar

K.S. "SIGKOS" Sh.a.  
Lagjja Kalabria, Kompleksi Riera, Hyrja Z10, Magjistralja  
Prishtinë-Shkup, 10000 Prishtinë, Kosovë

Data  
29.06.2023



Dega PËRPARIM MUJA B.I.

Numri i polices 060480010091616

**1 Të dhënat për agjentin - Agent details**

Emri dhe mbiemri	Adresa	Nr. i tel	Nr. ID
Përparim Muja	Prishtinë, Rruga Isa Boletini, Nr.59	044368333	048001

**2 SIGURUESI / Garantuesi: Kompania e Sigurimit " SIGKOS " sh.a., Prishtinë**

I SIGURUARI DEA GROUP SH.P.K.

Adresa Rr. Prekazi 36 Prishtine

Përfaqësuar nga Z. Arton Zeqiri Nr. i biznesit 811454636

**3 Siguruesi dhe i siguruari me vullnet të lirë , të barabartë dhe me mirëbesim lidhin këtë lloj sigurimi.**

Përshkrimi i mbulesës siguruese / Garancisë - Lloji: **SIGURIMI I EKZEKUTIMIT TË TENDERIT**

Projektimi per funksionalizimin e Repartit Pediatrik ne Spitalin e Pergjishshem ne Mitrovice 206-23-4648-2-3-6

a) Sigurimi i tenderit, Ekzekutimi i tenderit, Sigurim tjetër ) b) Titulli i mbulesës siguruese, c) Numri i prokurimit, etj.

Përfutuesi Ministria e Shëndetësisë

Adresa ZAGREBIT , P.N.

Shuma e siguruar € 582.45 €

**4 LËNDA E GARANCISË: Detyrimet e Palëve sipas kësaj Police të Sigurimit janë:**

- Mbështetur në këtë Policë- Garancie, Siguruesi/Garantuesi merrë përsipër që të plotësojë çdo detyrim kontraktor i cili është i garantuar me këtë Policë.
- Efekt i veprues i kësaj Police - Garancie, që do të thot fillimi i detyrimit të Siguruesit / Garantuesit fillon mbas përfundimit të afatit të fundit të përcaktuar në marrëveshjet dhe/ose kontratat e lidhura në mes të Siguruarit/Kontraktuesit dhe Përfutuesit që sjellin detyrimet kontraktore për kontraktuesin, që do të thot se Përfutuesi nuk mund të paraqes kërkesa në zbatim të kësaj Police kur Kontraktuesi është brenda afatit për përmbushjen e detyrimeve të tij ndaj Përfutuesit sipas dispozitave në fuqi.
- Përfutuesi e ka të drejten t'i drejtohet Siguruesit/Garantuesit për marrjen e dëmshpërblimit deri në shumën e garantuar, vetëm kur detyrimet kontraktuale nuk plotësohen për faj të Siguruarit/ Kontraktuesit - Ekzekutuesit të Kontratës.
- Me plotësimin e detyrimeve ndaj Përfutuesit, Siguruesit/Garantuesit i lind e drejta që t'i drejtohet të Siguruarit / Kontraktuesit, me të gjitha mjetet ligjore, për të bërë rimbursimin e shpenzimeve të kryera në funksion të plotësimit të detyrimeve ndaj Përfutuesit (cedimi i të drejtave nga Përfutuesi tek Siguruesi / Garantuesi)

Periudha e sigurimit/garancisë

Fillon me: 29.06.2023

Mbaron me: 18.08.2023

**5**

Shuma e siguruar	Primi neto €	TVSH	Primi total €
582.45 €	50.00 €	9.00 €	59.00 €

Ky Sigurim është lidhur sipas Kushteve të Përgjithshme të Sigurimit të Garancive të cilat janë pjesë përbërëse e kësaj Police.

Primi i sigurimit paguhet tërësisht  
Premium is paid completely 59.00 €

Datë 29.06.2023  
Data

Me këste: Numri i kësteve  
In Installments:Nr. of Inst.

Shënime tjera:

I Siguruari / The Insured  
Arton Zeqiri

Data e lëshimit / Issued date  
29.06.2023

Siguruesi / The Insurer  
Përparim Muja